

AKADEMIA TEATRALE 2023

STRUKTURA

Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor (TKOBAP), në bashkëpunim me Qendrën “Gjenerata e re”, njofton nisjen e programit të parë profesional muzikor në Shqipëri, Akademia teatrale.

Një projekt tërësisht i ri, iniciuar në kuadër të promovimit, zhvillimit dhe perfeksionimit të teknikës në disiplinën lirike. I ndërtuar mbi bazën e përvojave më të suksesshme ndërkombëtare, me në fokus të rinjtë shqiptarë e të huaj dhe fuqizimin e potencialit të tyre, në skenën e TKOBAP-së dhe përtej saj.

Studentët e Akademisë do të trajnohen rreth interpretimit skenik, teknikës vokale, trajnimeve specifike të stilit dhe interpretimit të “Bel Cantos” italiane. Kjo e fundit e përfaqësuar denjësisht nga sopranoja ikonike me famë ndërkombëtare të dekadave të fundit, Ermonela Jaho.

Nëpërmjet kësaj strukture ndërveprimi mes artistësh profesionistë siç është Akademia Teatrale, të rinjve do t’u krijohet mundësia të bëhen pjesë e masterclass-ve, nën kujdesin e veçantë dhe mjeshtëror të figurave artistike prestigjioze, si dhe të marrin mësim individualë nga mësues dhe artistë të njohur ndërkombëtarë.

Çdo kandidati fitues do t’i jepet mundësia që të marrë njohuri të reja artistike, të cilat do t’i pasurojnë eksperiencën individuale artistike. Ndërkaq, pjesë e stafit të Akademisë do të jenë pedagogë, koreografë, ballët-maestro, dirigjentë të shquar e shumë figura profesioniste të artit të muzikës, operës e baletit.

Masterclass-i do të zhvillohet në bazën e nevoja artistike që ka TKOBAP-ja për Sezonin Artistik 2023 dhe mbi disiplinim e muzikës së dhomës nga repertori gjerman. Kjo me qëllim njohjen dhe përvetësimin teknik nga të rinjtë e talentuar, si në drejtim të muzikës operistike, po ashtu edhe të muzikës së dhomës.

Në këtë kuadër, Akademia teatrale do të finalizohet me 2 tituj të rëndësishëm të Operës ndërkombëtare, siç është opera “Atila” dhe “Carmen”.

QËLLIMI

- Akademia Teatrale, si një platformë profesionale, ju jep mundësinë pjesëmarrësve të punësohen në një model aktual, të qëndrueshëm e të vazhdueshëm, me standarde të larta ndërkombëtare.
- Kjo akademi do të rikthejë në vendin tonë, një brez të ri artistësh, të barasvlershëm me investimin e bërë në edukimin e tyre.
- Mbi të gjitha, artistët e rinj do mund të pasurojnë repertorin artistik të veprave që nuk i kanë debutuar përgjatë viteve akademike apo përgjatë eksperiencës së tyre artistike.

- Pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të studiojnë me disa nga figurat më të suksesshme të muzikës, duke iu siguruar një rritje të garantuar të performancës së tyre artistike.
- Në fund të kësaj eksperiencë, të rinjtë do të kenë mundësinë të pajisen me një portofol profesional, të mbushur me përvoja të vyera mjeshtërore, me të cilat do mund të konkurrojnë me bashkëmohatarët e tyre evropianë, si dhe me ata përtej oqeanit.

LËNDËT STUDIMORE

- Arti dhe teknika e vokalizmit
- Arti, teknika, interpretimi dhe parimet themelore të Bel Canto-s
- Studimi i partiturës
- Historia dhe praktika interpretuese e operës
- Teknika vokale
- Fiziologjia e instrumentit vokal
- Fjalor lirik
- Teknika aktoriale dhe punëtoria e aktrimit
- Masterklasa e interpretimit
- Masterclass: Kultura e profesionit të këngëtarit të operës

KRITERET E PRANIMIT

Aplikantët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Të dërgojë në mënyrë elektronike një video prezantimi, ku prezanton punën e tij dhe performon 2 arie complete, në stile të ndryshme.
- Të dërgojë jetëshkrimin (CV) e tij/ saj të përditësuar dhe kopje të diplomës apo diplomave me kualifikime muzikore.
- Kandidatët e Akademisë teatrale duhet të jenë në moshën 18-30 vjeç
- Për t'u bërë pjesë e Akademisë Teatrale, do të kalohet përmes testim paraprak përzgjedhës bazuar në jetëshkrimin dhe prezantimin e tyre me anë të një videoje.
- Audicionet do të zhvillohen fizikisht vetëm për kandidatët që konsiderohen të përshtatshëm nga përzgjedhja paraprake.